



---

Memorandum Bashkëpunimi  
*Për Programin Ballkanik të Paqës 2014*

---

I. Hyrje

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi lidhet ndërmjet Fondacionit Bislimi Grup (tutje referuar si Fondacioni) dhe Universitetit Publik të Gjilanit "Kadri Zeka" (tutje referuar si Universiteti) për realizimin e Programit Ballkanik të Paqës 2014 nga 2 deri më 23 Gusht 2014 në Gjilan.
2. Fondacioni Bislimi Grup ka organizuar dhe administruar Programin Ballkanik të Paqës që nga viti 2012. Programi Ballkanik i Paqës (PBP) është program veror akademik i cili që nga viti 2013 gëzon edhe mbështetjen dhe njohjen institucionale ndërkombëtare nga University of Alberta International në Edmonton, Alberta, Kanada.
3. PBP sjellë në Gjilan një grup studentësh (rreth 12, +/- 3) të huaj si pjesëmarrës të këtij programi, ligjëratat dy-javore të të cilit mbahen në gjuhën angleze. Qëllimi i programit është që të ofrojë mundësi për studentët e huaj që të njihen më për së afërmi me Kosovën, traditën dhe kulturën shqiptare, si dhe të kaluarën e vendit tonë. Këtë vit, tema e programit është "Zhvillimi Ndërkombëtar dhe Politika në Shoqëritë e Pasluftës: Kosova dhe Ballkani".
4. PBP është i hapur edhe për pjesëmarrës / studentë vendorë, të cilët, si pjesëmarrës të këtij programi do ta kenë mundësinë të njihen për së afërmi me kolegët e tyre të huaj, si dhe realizimin e ligjeratave dhe studimeve tipike në gjuhën angleze në një universitet të huaj. Përvoja është e shkëlqyeshme për të dyja palët – si studentët vendorë, ashtu edhe ata të huaj.

5. Sikur edhe në vitet paraprake, studentët e huaj—pjesëmarrës të këtij programi—do të vendosen në familje nikoqire në Gjilan për kohën e qëndrimit të tyre në Kosovë. Në këtë mënyrë, ata do të kenë mundësinë që për së afërmi të njihen me traditën dhe kulturën shqiptare dhe të krijojnë miqësi të përherëshme me kolegët e tyre nikoqirë.

## II. Përgjegjësitë e Fondacionit

1. Fondacioni është përgjegjës për shpërndarjen e aplikacioneve dhe përzgjedhjen e kandidatëve të huaj për pjesëmarrje në PBP 2014. Lista finale e të përzgjedhurëve do t'i bëhet e ditur edhe Universitetit deri më 30 Qershor 2014.
2. Fondacioni është përgjegjës për ndihmesën në organizimin e udhëtimit të studentëve të huaj për dhe nga Kosova, si dhe për organizimin e ekskurzionit nëpër Kosovë dhe vizitave tjera në vendet fqinje, sic parashihen me Agjendën e Programit, gjatë javës së fundit të programit.
3. Fondacioni, në bashkëpunim me Universitetin, është përgjegjës për organizimin e ligjëratave dhe ceremonisë festive të ndarjes së Certifikatave për pjesëmarrësit e programit në fund të programit.
4. Fondacioni, në bashkëpunim me Universitetin, është përgjegjës për organizimin e paraqitjeve mediale dhe komunikimeve tjera me publikun sipas nevojës.

## III. Përgjegjësitë e Universitetit

1. Universiteti është përgjegjës për të ofruar një dhomë mësimi / klasë me kapacitet prej së paku 45 ulseve, me projektor dhe kompjuter, si dhe një zyre individuale pune për ligjëruesin, për kohëzgjatjen e programit, pra nga 2 deri me 23 Gusht.
2. Universiteti, në marrëveshje me Fondacionin, mund t'i jap rast ligjëruesëve të vet që janë kompetent në gjuhën angleze që të jenë "ligjërues nderi" në ndonjërin nga ligjëratat e programit.
3. Universiteti, në bashkëpunim me Fondacionin, është përgjegjës që të gjejë nikoqirët e duhur nga studentët e vet për studentët e huaj.
4. Universiteti do të përzgjedhë (10) dhjetë studentë të vet të cilët do të ndjekin ligjëratat e këtij programi pa pagesë. Lista e studentëve të përzgjedhur nga Universiteti të cilët do të vijojnë ligjëratat e programit dhe do të marrin certifikatat përkatëse në fund të tij do t'i dorëzohet Fondacionit deri më 30 Qershor.
5. Universiteti do të caktojë / emërojë një zyrtar të vetin për të qenë bashkë-koordinator apo bashkë-udhëheqës i këtij programi me homologun nga Fondacioni.

#### IV. Përfitimet e Përbashkëta

1. Fondacioni dhe Universiteti do të përfitojnë nga ky bashkëpunim në disa aspekte, duke përfshirë:
  - a. Krijimin e mundësisë për Universitetin që të jetë nikoqir i një programi akademik ndërkombëtar, certifikatat dhe kreditë e të cilit deri më tani janë njohur dhe pranuar ndërkombëtarisht nga shumë universitete në Evropë e Amerikë Veriore (SHBA e Kanada).
  - b. Pas realizimit të suksesshëm të programit, Fondacioni do të vazhdojë bashkëpunimin ndërinstitucional me Universitetin duke aranzhuar një vizitë pune në Kanada për krerët e Universitetit për të hapur mundësi të reja bashkëpunimi me universitetet kanadeze.
  - c. Ofrimin e mundësisë për studentët e Universitetit të jenë pjesë e një programi akademik ndërkombëtar në vendin e tyre.
  - d. Krijimin e një partneri lokal për Fondacionin në realizimin e vizionit dhe misionit të vet për ofrim të mundësive për arsimim kualitativ për studentët e Gjilanit dhe Kosovës.

#### V. Financat

1. Kosto e pjesëmarrjes së studentëve të huaj në këtë program rregullohet ekskluzivisht në mes atyre dhe Fondacionit.
2. Fondacioni do të ofrojë 10 (dhjetë) bursa të plota për 10 (dhjetë) studentë të përzgjedhur të Universitetit për të qenë pjesëmarrës të pjesës akademike të programit pa pagesë. Poashtu për të gjithë studentët nikoqirë, Fondacioni po ashtu do të ofrojë pjesëmarrje në pjesën akademike të programit pa pagesë.
3. Përveq pjesëmarrjes falas në pjesën akademike të programit dhe pajisjes me certifikata në fund, për të gjithë nikoqirët që në shtëpitë dhe familjet e tyre do të akomodojnë studentët e huaj, Fondacioni ofron edhe një grant shtesë prej 120.00 EUR për nikoqir.
4. Nikoqirët duhet të flasin / kuptojnë gjuhën angleze dhe të kenë kushte normale për jetesë në shtëpinë e tyre.
5. Fondacioni do të provojë të gjejë edhe donatorë eventual ashtu që të ketë mundësi të ofrojë edhe më shumë burësa të plota për studentë vendorë që duan të jenë pjesë e këtij programi.

#### VI. Përmbyllja e Programit dhe Certifikatat

1. Në fund të programit, për të gjithë vijuesit e rregulltë do të ndahen Certifikatat e Programit në gjuhën angleze të cilat do të mbajnë logon e Fondacionit, University of Alberta International, dhe atë të Universitetit.

2. Pjesëmarrësve të huaj në program do t'iu jepet edhe nga një transkript që vërteton pjesëmarrjen e tyre në program dhe kreditë adekuate të tij, respektivisht, 7 ECTS, sipas sistemit të kredive akademike në Kosovë.
3. Ceremonia e ndarjes së certifikatave do të organizohet në bashkëpunim nga Fondacioni dhe Universiteti.
4. Të gjithë pjesëmarrësit në program inkurajohen që të shkruajnë një ese në fund të programit. Kjo është obligative për studentët e huaj. Esetë duhet të jenë në anglishtë dhe jo më të gjatë se 5000 fjalë.
5. Eset mandej editohen dhe përzgjidhen nga profesorë ndërkombëtarë për t'u botuar në një libër me recension ndërkombëtar i cili do të botohet në SHBA apo Kanada përmes një shtëpie botuese akademike.

#### VII. Përfundimtare

1. Ky Memorandum Bashkëpunimi hynë në fuqi në datën e nënshkrimit nga të dyja palët dhe skadon pas përfundimit të të gjitha aktiviteteve të ndërlidhura me PBP 2014.
2. Për çfarëdo mosmarrëveshje eventuale, kompetente janë gjykatat përkatëse në Kosovë.

Gjilan, më 17 Qershor 2014

Për Universitetin Publik të Gjilanit  
"Kadri Zeka"

Prof. Dr. Arben Dërmaku  
Rektor

Për Fondacionin Bislimi Grup

Faton Bislimi  
Themelues dhe President